

VENDIM
Nr. 450, datë 23.5.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË ZNJ. MARJANA PRENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 650 000 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të znj. Marjana Prendi.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha